



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I BASHKISË TEPELENË**

Nr. 2267 prot.

Tepelenë më, 15.12.2025.

Drejtuar : Kryetarit të Bashkisë Z. Gramos Sako

Lënda : Dërgohen për opinionin tuaj rekomandimet dhe kërkesat e qytetarëve dalë nga konsultimi publik për PBA 2026-2028 , Projekt-buxhetin 2026, Paketa Fiskale, organizuar nga Bashkia Tepelenë, Këshilli i Bashkisë Tepelenë në Njësitë Administrative.

I nderuar Z. Kryetar!

Në zbatim të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” Neni 54, si dhe të Vendimit të Kryesisë së Këshillit të Bashkisë, Komisioni i Financës dhe Buxhetit realizoi procesin e konsultim publik me komunitetin në përputhje me Regulloren për Konsultimin Publik, në lidhje me “Programi buxhetor afatmesëm 2026 – 2028” Projekt- buxhetin 2026, Paketa Fiskale të paraqitur nga ana Juaj.

Konsultimi publik kishte në fokus diskutimin me komunitetin dhe marrjen e rekomandimeve në lidhje me” PBA 2026- 2028”, Projekt- buxhetin 2026, Paketa fiskale të Bashkisë Tepelenë.

Po ju percjellim në opinionin tuaj cdo rekomandim dhe kërkesë të qytetarëve, dalë në konsultimin publik në Njësitë Administrative të Bashkisë Tepelenë si më poshtë :

**Njësia Administrative Kurvelesh:**

**Infrastrukturë dhe shërbime publike**

- Ndërtimi i kanalizimeve të ujërave të zeza fshati Progonat.
- Restaurimi i ambienteve sportive, dhe garantimi i funksionalitetit të ndriçimit publik.
- Ndërhyrje në rrugët e brendshme të fshatrave, Gusmar, Progonat Qendër fshatit – (Kërmaj)

- BASHKIJA E TEPELENË
- Përmirësimi dhe rehabilitimi i ujësjellësve ekzistues.
  - Vendosja e një tarife afrofe për shërbimin e ujësjellësit gjatë periudhës së dimrit, për shkak të kushteve klimatike dhe ngrirjes së rrjetit (dëmtohet tubacioni I furnizimit me ujë në banesë).
  - Rikonstruktion, qendra e fshatit Progonat, Gusmar.
  - Rehabilitim ujësjellësi fshatit Gusmar.

## **2. Bujqësi, blegtori dhe kullota**

- Ndërhyrje emergjente për pastrimin dhe përmirësimin e kullotave.
- Shqetësim nga ana e pronarëve të kullotave private lidhur me nivelin e tarifave të kullotave.
- Përfundimi i procedurave të tenderimit për lerat dhe marrja e masave administrative në rastet e mosrespektimit të kontratave.
- Sigurimi i lerave ekzistuese dhe përmirësimi i infrastrukturës mbështetëse.

## **3. Planifikim dhe administrim territori**

- Zgjidhja e kërkesave të mbetura pezull për leje ndërtimi për banesa dhe biznese.
- Përditësimi i regjistrave të pasurive, lerave dhe rrugëve në territorin e njësisë.
- Caktimi i një pike të posaçme për sigurimin e materialeve ndërtimore për nevojat e komunitetit (material natyral për ndërtim).
- Ndërtimi i një muri rrethues në shkollën e fshatit Nivicë dhe sistemimi i fushës së futbollit.

## **4. Shëndetësi dhe shërbime sociale**

- Organizimi i vizitave të Mjekut të Familjes për të moshuarit, sipas një kalendari të përcaktuar në qendrën shëndetësore.

## **5. Turizëm**

- Harëzim dhe markimi i shtigjeve turistike.
- Vendosja e tabelave orientuese dhe informuese në territorin e Njesisë Administrative Kurvelesh.

## **Njësia Administrative Lopës :**

### **Infrastrukturë dhe shërbime publike:**

- Ndërhyrje dhe përmirësim i ambienteve të zyrave të kryesisë së fshatit Dhëmban.

- Mirëmbajtje e rregullt e varrezave (pastrim, rrethim dhe sistemim), duke qenë se në disa fshatra ekzistojnë disa qendra varrezash, fshati Dhëmblan
- Përmirësim i ndriçimit publik në fshatra, duke zëvendësuar dhe riparuar pajisjet e dëmtuara.
- Ndjekja dhe verifikimi i punimeve deri në përfundimin e plotë të tyre.
- Riparim i çezmave publike dhe përmirësim i furnizimit me ujë.
- Mbjellje pemësh dhe gjelbërim i qendrave të fshatrave dhe zonave përreth lapidarëve, (fshati Dhëmblan)
- Ndërhyrje në shkolla, fshati Matohasanaj (izolim, rikonstruksion dhe përmirësim të kushteve të mësimi).

#### **8. Uji i pijshëm dhe kanalizimet**

- Zgjidhje e problematikës së furnizimit me ujë të pijshëm në Fshatin Sinanaj:
  - Vendosijes së pompave,
  - Shtrirjes së tubacioneve,
  - Hartimit të projekteve për furnizim me ujë.
- Ndërtimi i sistemit të kanalizimeve të ujërave të zeza, fshati Sinanaj.

#### **9. Rrugë dhe lidhje infrastrukturore**

- Ndërhyrje për përmirësimin e rrugëve lidhëse dhe rrugëve të brendshme të fshatrave.
- Ndërtimi dhe përmirësimi i rrugëve Fshati Dorëz (ura, tubina).
- Asfaltimi i segmenteve problematike rrugore.
- Rikonstruksion rruge fshati Matohasanaj
- Rrethimi i varrezave dhe ndalimi i ndërtimeve të papërshtatshme në këto zona, (fshati Lab-Martaloz)
- Përmirësimi i ndriçimit publik në zona problematike.
- Pastrimi dhe mirëmbajtja e segmenteve rrugore kryesore, Sinanaj- Tepelenë

#### **10. Bujqësi, kullota dhe lera**

- Mirëmbajtje, rikonstruksion dhe funksionimi i lërave ekzistuese.
- Hartimi dhe zbatimi i projekteve për pastrimin e kullotave.
- Mbledhja dhe administrimi i të ardhurave nga toka bujqësore.

#### **Njësia Administrative Qëndër, Qytet.**

- Përmirësimi i rrjetit të ujësjellësit dhe sistemimi i qendrave të fshatrave.
- Hapja dhe pastrimi i lërave për blegtori.

- Zgjerimi i sistemit të ndriçimit publik në fshatra, përfshirë instalimin e paneleve diellore.


#### **Prioritetet kryesore sipas fshatrave:**

- **Hormovë:** Pastrim i përroit të Gurrës, shtrim me beton i 400 m, përmirësime asfaltike, furnizim me ujë në lagjet sipërme dhe poshtme.
- **Lekël:** Shtrim me beton (200 m), pastrim dhe krijim lerash të reja, ndërtim kanal vaditës 1.5 km.
- **Kodër:** Shtrim me beton (350 ml), hapje dhe rehabilitim i kanalit vaditës.
- **Peshtan:** Ndërhyrje në përrua, rehabilitim çezme, shtrim rruge (300 ml), ndërtim ujësjellësi.
- **Mezhgoran:** Asfaltim rrugësh, sistemim rrugësh të brendshme.
- **Dragot:** Ndërhyrje në qendër fshati, shtrim me beton drejt "kalasë" (200 m), rehabilitim kanalesh kulluese.
- **Beçisht:** Përmirësim shtresa asfaltike e rugës lidhëse, shtrim me beton (250 ml), riparim/rikonstrukcion çezme/ujësjellës, rehabilitim lerash.
- **Luzat:** Shtrim rrugësh të brendshme (350 m), ndërtim qendre dhe ujësjellësi.
- **Benç:** Sistemim rrugësh të brendshme (150 ml), hapje rrugë drejt parcelave.
- **Veliqot:** Shtrim me beton (350 m), mirëmbajtje qendre, sistemim rrugësh drejt parcelave.
- **Turan:** Ndërhyrje qendër fshati, shtrim me beton (300 m), ndërtim ujësjellësi, rrethim varrezash, ndërtim dhe pastrim lere.
- **Dukaj:** Shtrim rrugësh, pastrim lerash, ndërhyrje rruga Dukaj–Kordhaj, asfaltim Kordhaj–Memaliaj, ujësjellës dhe sistemim përroi.
- **Salari:** Ndërhyrje Qendër fshati, rrethim varrezash, shtrim rrugësh (500 m), pastrim dhe mirëmbajtje lerash.
- **Mamaj:** Shtrim me beton (200 m), sistemim qendër, ndërtim emergjent ujësjellës.

#### **Kërkesa të qytetarëve dhe objektiva të përgjithshme:**

- Planifikim qendre sociale për pensionistë në Tepelenë.
- Ndërhyrje dhe sistemim tregu qyteti.
- Investime në pallatet e banimit (izolim/kapot).
- Promovim dhe mbështetje e agroturizmit dhe produkteve vendase.
- Vlerësim mundësie për ndërtim muze pranë Kalasë së Tepelenës.
- Blerja e pajisjeve për pastrimin e qytetit.
- Pajisje me zyrë infopoint dhe sinjalistikë turistike me shtrirje në gjithë zonën.
- Guidë/Udhërrëfyes, turistik sezonal.
- Ndërtimi një parkimi publik për autobuzë dhe mjete të vogla.

Lutemi për një pergjigje dhe angazhim të ekzekutivit për reflektimin e tyre në PBA 2026- 2028.

  
Në pritje të opinionit tuaj për cdo kërkesë dhe rekomandim,

Ju falenderojmë!

Me kondsideratë,

**Kryetar i Këshillit**

**Arben Gumeni**



**Sekretar i Këshillit**

**Valbona Çela**